



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Qeverisje Lokale, Administratë Publike, Zhvillim Rajonal dhe Media

Mbledhja nr. 57

Prishtinë, me 28 shtator 2023 në orën: 13.00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Valon Ramadani, Isak Shabani, Fidan Jilta, Nijazi Isaku, Fitim Haziri, Besim Muzaqi dhe Agim Veliu.

Munguan: Arbëreshë Kryeziu-Hyseni, Mergim Lushtaku dhe Besnik Tahiri.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Valon Ramadani, kryetar i komisionit, me këtë:

Rend të ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit, për sesionin vjeshtor 2023;**
- 3. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit, për sesionin vjeshtor 2023;

Valon Ramadani, njoftoi anëtarët e komisionit, se mbi bazë të Programit Legjislativ të Qeverisë dhe Rregullores së Kuvendit, komisionet parlamentare, i hartojnë planet e punës dhe ato periodike. Draft –plani i punës së komisionit për sesionin vjeshtor është përgatitur në bazë të Programit Legjislativ të Qeverisë dhe i njëjti mund të plotësohet me propozime.

Komisioni propozoi për muajin nëntor të ftohen për raportim Agjencia e Statistikave të Kosovës,
- të shqyrtohet raporti gjithëpërfshirës për shërbimin civil,

- shqyrtimi i P/ligjit për aktet normative të Komunave;

- shqyrtimi i P/ligjit për pronën e paluajtshme të Komunave;

- shqyrtimi i P/ligjit për bashkëpunim ndërkomunal; dhe

- shqyrtimi i P/ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura.

Konstatim: Komisioni miratoi Planin e Punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2023.

3. Të ndryshme.

Valon Ramadani, pyeti anëtarët e komisionit, po qe se ka dikush propozime, diskutime apo kërkesa. Meqë nuk kishte kërkesa për diskutim, mbledhja përfundoi.

Mbledhja përfundoi në orën: 13:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Valon Ramadani,

Kryetar i Komisionit
